



Islamic Relief Kosova

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

NJOFTIM

Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural sipas Planit të Punës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2024, bazuar në Rregulloren Komunale me Nr. Prot.02-060/01-0039654-3/23, dt.31.05.2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Marrëveshjen për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Islamic Relief Kosova- Zyra në Kosovë (IRW) me Nr. Prot.01.400/01-0054689/23, dt. 20.07.2023 për realizimin e projektit “Fuqizimi i ekonomisë rurale dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave”, për Komunën e Mitrovicës së Jugut, ka marrë vendim për mbështetjen e sektorit të zhvillimi rural duke i subvencionuar fermerët me grante si:

Panele solare

I. Kriteret e përgjithshme për aplikim për panele solare (1.25 kW)

- Të jetë banor i Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Lokacioni i fermës të jetë brenda territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Të ketë minimum 10 krerë lopë qumështore, ose 100 krerë dele/dhi qumështore, ose 2000 copë pula vojse/brojler, ose 50 shoqëri bletesh, ose 500 m² serrë ose 2 ha pemë;
- Të ketë sipërfaqe të tokës bujqësore dhe të mjaftueshme;
- Përfituesi i grantit duhet të participojë në financimin e grantit me 20% nga vlera e përgjithshme e grantit të fituar;
- Përfituesit nuk kanë të drejtë që të shesin apo të tjetërsojnë panelet solare në tre (3) vitet pasuese;
- Kushtet specifike në mes të përfituesit Islamic Relief Kosova dhe Komunës, do të përcaktohen përmes kontratës së nënshkruar në mes të palëve, e cila përfshinë përgjegjësitë dhe obligimet në mes të palëve.

Kriteret specifike për aplikim për panele solare në kushte të barabarta përparësi kanë:

- Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
- Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar dy vitet e fundit;
- Aplikuesit të cilët kanë numër më madh të krerë dhe sipërfaqe më të madhe me pemë dhe perime në serrë;
- Aplikuesit me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti i bujqësisë).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për panele solare:

- Kërkesën e plotësuar për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Çertifikatën e regjistrimit nga regjistri i fermës si fermerë (NIF);
- Vërtetimin e lëshuar nga praktikant veterinar, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit & Regjistrimit të kafshëve në AUV, për lopët, dele dhe dhi qumështore ose pula vojse/brojler;
- Raportin nga EFR- për pemë, perime në serrë dhe shoqëri bletesh;
- Deklaratën e bashkësisë familjare (*kërkohe vetëm origjinal*);
- Listën poseduese të tokës bujqësore, toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum për 5 vite (*kërkohe vetëm origjinal*), pronësia duhet të dëshmohe përmes çertifikatave të lindjes ose të vdekjes nëse lista poseduese nuk është në emër të aplikuesit.

Marrja e aplikacioneve si dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën pritëse në Komunën e Mitrovicës së Jugut, prej datës 29.05.2024 deri me datën 13.06.2024, nga ora 9.00-15.00 h.

Vëmendje:

- Dokumentet e pa kompletuara, dhe të dorëzuara pas përfundimit të afatit të aplikimit nuk do të shqyrtohen.

Albulena GASHI-HAJRULLAHU
Islamic Relief - Kosova Office



Ferdi KADRIU

Drejtor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

